



USAID
NGA POPULLI AMERIKAN



Center for Civil Communications
Центар за граѓански комуникации



МАКЕДОНСКИ
ЦЕНТАР ЗА
МЕЃУНАРОДНА
СОРАБОТКА

UDHËZUES PËR QYTETARËT



PËR MBIKËQYRJE TË PROKURIMEVE PUBLIKE

Si t'i njihni mashtrimet për kurdisje të ndonjë tenderi
Çka të bëni nëse vëreni ndonjë prej mashtrimeve
Si dhe ku të denonconi korrupsion
Si të fitoni më tepër informacione për ndonjë tender



390 milionë euro në vit për nevojat e qytetarëve në vend që për korrupsion!



💡 Paramendoni shteti të jetë në gjendje në periudhë prej një viti të ndërtojë 550 kopshte bashkëkohore për fëmijë.

💡 Paramendoni shteti të jetë në gjendje në periudhë prej një viti të ndërtojë mbi 100 shtëpi për pleq.

💡 Paramendoni shteti të jetë në gjendje në periudhë prej vetëm një viti të ndërtojë rrugë me shtigje për këmbësorë dhe shtigje për biçikleta dhe kanalizim të ri atmosferik në gjatësi prej 400 kilometra.

💡 Paramendoni shteti të jetë në gjendje në periudhë prej një viti të blejë më tepër se një mijë aparate mjekësore.

- ▶ E gjithë kjo do të ishte e mundur, nëse ne, qytetarët, do të ndalonim korrupsionin që ndodh në prokurimet publike, e të cilat i zbatojnë institucionet shtetërore të nivelit qendror dhe nivelit lokal.
- ▶ Çdo vit, për prokurime publike, në shtet shpenzohen përafërsisht nga 80 miliardë denarë, që është rreth 1 miliardë e 300 milionë euro. Blihen produkte dhe shërbime ose realizohen punë ndërtimore me para publike që grumbullohen nga secili prej nesh – qytetarët, nëpërmjet pagesave për tatimet, kontributet, taksat dhe ngjashëm.
- ▶ Vlerësimet janë që një e treta e këtyre parave keqpërdoren dhe janë lëndë korrupsioni. Kjo donë të thotë që, në nivel vjetor, korrupsioni në prokurimet publike na kushton madje 390 milionë euro!!!
- ▶ Përkatësisht, në vend që për blerje të aparateve mjekësore dhe ndërtim të rrugëve të reja, të kopshteve për fëmijë, të spitaleve etj., këto para përfundojnë në xhepat privatë të ndokujt.
- ▶ Për shkak të korrupsionit, autoritetet qendrore dhe lokale vazhdimisht i anulojnë projektet, të cilat janë të rëndësishme për ne qytetarët, ndërkaq shpesh edhe ajo që blihet ose ndërtohet është me cilësi të dobët.
- ▶ Që të mos lejojmë punët të bëhen edhe më keq, të gjithë në, si qytetarë duhet të kushtojmë vëmendje ndaj prokurimeve publike.
- ▶ Duhet të përcjellim mënyrën se si realizohen prokurimet, t'i bëjmë pyetjet e duhura, të ndikojmë në vendimet për atë se çka do të blihet, për të pamundësuar korrupsionin dhe të kontribuojmë që paratë tona të shpenzohen për të mirën tonë.

Mashtrime për kurdisje të tenderit



Si t'i njihni mashtrimet që bëhen për t'u kurdisur ndonjë tender, përkatësisht t'i "jepet" ndonjë firme "mik"? Ja disa prej tyre.

- ◀ Prokurohet diçka që nuk është e nevojshme, mirëpo diçka që firma "mik" e shtet dhe e cila duhet ta fitojë tenderin. Për shembull, blihet një ton letër për printim, edhe pse realisht nevojitet një sasi më e vogël.
- ◀ Kushtet që duhet t'i plotësojnë firmat në tender janë të "përshtatura" në mënyrë që të mund ato t'i plotësojë vetëm firma "mik". Madje 45% e firmave në vendin tonë konsiderojnë që tenderët në shtet kurdisen në këtë mënyrë.
- ◀ Në tender "akrohet" konkurrencë. Në tender marrin pjesë edhe nga tre ose më shumë firma, mirëpo çmimet që i ofrojnë firmat tjera janë shumë herë më të larta nga çmimi të cilin e ofron firma "mik", me qëllim që oferta e asaj firme të jetë më e mira. Ose, firmat tjera bëjnë gabime në plotësimin e dokumentacionit të tenderit, që të jenë të përjashtuara gjatë evaluimit dhe oferta e tyre aspak të mos merret parasysh. 54% e firmave pohojnë që firma të caktuara merren vesh ndërmjet vete në këtë mënyrë para tenderëve.
- ◀ Tenderi shpallet kah fundi i muajit korrik ose në fillim të muajit gusht – mu në periudhën kur numri më i madh i njerëzve janë nëpër pushime. Në atë mënyrë, shmangët konkurrenca dhe në tender paraqitet vetëm firma e cila do ta dijë paraprakisht se do të ketë tender në atë periudhë.
- ◀ Të gjitha firmat tjera eliminohen në fazën e vlerësimit të ofertave, ashtu që, në fund ngel vetëm oferta nga fir-



ma "mik". Institucionet në vend, çdo vit, vetëm në fazën e evaluimit të ofertave në total refuzojnë më tepër se 60.000 oferta. Në më tepër se 30% të tenderëve, megjithëse ka pasur më tepër oferta, në fund ka ngelur vetëm një ofertë për shkak se të tjerat janë refuzuar.

- ◀ Nëse ndonjë prej këtyre mashtrimeve nuk janë të suksesshëm, tenderi anulohet (nëse ka nevojë edhe nga disa herë) dhe prokurimi përsëritet derisa atë ta fitojë firma "mik".
- ◀ Pasi të nënshkruhet kontrata dhe të fillojë realizimi i tenderit, rritet "kostoja" që të ketë mjaftueshëm para për të gjithë. Për shembull, për shkak se janë shfaqur çështje të paparapara. Ose, firma nuk do të duhet të realizojë të gjitha gjëra që janë përcaktuar në kontratë ndërsa për të cilat institucioni do të paguajë. Përsëri – me qëllim që të mbetet mjaftueshëm para për të gjithë. Për shembull, ngjyra te kalimi i këmbësorëve zbehët dhe fshihet pas vetëm disa ditëve pasi është ngjyrosur dhe nuk reflekton ditë.

Çka të bëni nëse vëreni ndonjë prej mashtrimeve?

Nëse vëreni ndonjë prej këtyre mashtrimeve më të shpeshta, ose ndonjë dukuri tjetër që ju duket si manipulim/mashtrim, keni të drejtë të reagoni!

Keni të drejtë të kërkoni që komuna juaj të prokurojë diçka nëse konsideroni se është e nevojshme për qytetarët. Shporta të reja për hedhurina, banka për t'u ulur, shteg për këmbësorë, platformë për hyrje në ndërtesa, trotuare, etj.

Në të kundërtën, keni të drejtë të reagoni edhe nëse konsideroni që diçka nuk është e nevojshme, ndërsa prokurohet. Për shembull, ka banka të cilat janë në gjendje të mirë dhe janë funksionale për t'u ulur, ndërsa vendohen të reja.

Ose, në raste tjera, diçka është bërë, por zgjatë për një kohë të shkurt. Pas reshjeve të para të shiut, janë hapur vrima në rrugën e re, ose bankat e reja janë gërryer pas një kohe të shkurtë pasi janë vendosur. Për një kohë të shkurtë, shtegu i ri i këmbësorëve është shkatërruar.



Si dhe ku të denonconi korrupsion?

Nëse konsideroni se ekzistojnë parregullsi në ndonjë prokurim publik, mund të denonconi këtë në komunë, ndërkaq, nëse komuna nuk reagon, mund ta denonconi edhe në Komisionin Shtetëror për Parandalim të Korrupsionit, edhe atë, në cilin do të rast apo fazë të prokurimit. Mund të denonconi edhe vetëm në Komision, pa e denoncuar rastin fillimisht në komunë, nëse konsideroni se ashtu është më mirë.

Denoncimin mund ta bëni personalisht në institucion, por edhe nëpërmjet shkrësës anonime, me dërgim të mesazhit elektronik (e-mail) ose përmes telefonit. Është mirë të jeni sa më të hollësishtëm dhe të siguronit sa më tepër informacione, fotografi, dokumente dhe të dhëna që të "përforconi" denoncimin tuaj.

Në Komisionin Shtetëror, korrupsion mund të denonconi në telefonin (02) 3248 930, përmes dërgimit të postës elektronike në: contact@dksk.org.mk ose në formë të shkruar, në këtë adresë: Komisioni Shtetëror për Parandalim të Korrupsionit, bulevard Presveta Bogorodica nr. 3, 1000 Shkup.

Nëse denoncimi nuk është anonim, përmendni që dëshironi t'ju informojnë për mënyrën si ka përfunduar rasti i denoncuar. Në atë mënyrë, do ta zmadhoni presionin mbi institucionin për të reaguar lidhur me denoncimin tuaj.



Si të fitoni më tepër informacione për ndonjë tender?

Mund të kërkonte edhe informacione shtesë për prokurimin publik. Disa prej tyre mund t'i gjeni edhe vet, në internet. Viteve të fundit, komunat publikojnë gjithnjë e më tepër informacione për tenderët. Mirëpo, prokurimet publike zbatohen nëpërmjet të ashtuquajturit Sistemi Elektronik për Prokurime Publike, në të cilin, secili mund të gjej informacione për prokurimin, në ueb faqen: <https://e-nabavki.gov.mk/>.

Së pari, kontrolloni në sajtin e komunës

Nëse shkoni në ueb-faqen e komunës, së pari kontrolloni nëse ka ndonjë seksion për prokurime publike. Aty duhet të jetë plani vjetor për prokurime publike, në të cilin është cekur çka planifikohet të prokurojë komuna gjatë vitit. Këtu do të shihni nëse ka ndonjë prokurim të palogjikshëm, sikur që një komunë me shumë probleme tjera të pazgjidhura komunale, kishte paraparë në plan të ndërtojë terren për të luajtur golf.

Pastaj, në sajtin e komunës mund të gjeni informacione për “shpalljet” për prokurime publike. Aty ka informacione më konkrete lidhur me atë se çka komuna dëshiron të prokurojë.




Në informacionet bazike të shpalljeve mund të gjeni të dhëna për lëndën e prokurimit, afatin e përcaktuar për firmat që t'i dërgojnë ofertat, por edhe ditën, kohën dhe vendin kur ofertat e grumbulluara do të jenë të hapura në mënyrë publike. Çdo qytetar dhe firmë në shtet mund të jetë i pranishëm gjatë hapjes publike të ofertave, të cilën e bën komisioni i përcaktuar për prokurimin publik dhe nga e cila përpilohet procesverbal zyrtar. Në shpalljen është i cekur edhe personi për kontakt për prokurimin konkret, më së shpeshti me numër telefonik dhe adresën e postës elektronike.

Në lidhje me shpalljet është edhe i ashtuquajturit dokumentacion i tenderit, të cilin mund ta gjeni në çdo shpallje dhe në të është përshkruar më detajisht lënda e prokurimit, sasitë që do të prokurohen, por edhe kushtet që duhet t'i plotësojnë firmat që të mund të marrin pjesë në tender. Ky dokument është një nga dokumentet kryesore për çfarëdo inspektimi ose monitorimi të ndonjë prokurimi publik.

Dokumentin e radhës që mund ta gjeni për prokurimet është i ashtuquajturit njoftim për marrëveshje të nënshkruar. Në këtë njoftim ka informacione lidhur me atë se cila firmë e ka “fituar” tenderin, cilat firma tjera kanë marrë pjesë në prokurimin, si dhe cila është vlera e prokurimit. Në lidhje me njoftimet është një nga dokumentet më të rëndësishme për prokurime publike që është në dispozicion për publikun – marrëveshja për prokurimin publik që institucioni e nënshkruan me firmën e cila e ka fituar tenderin. Në marrëveshjen ka të dhëna për kohëzgjatjen, çmimin individual të produkteve dhe shërbimeve të prokuruar, kushtet që duhet t'i plotësojë firma, detyrimet e institucionit, etj. Përveç marrëveshjes, në dispozicion janë edhe anekset e mundshme të marrëveshjes, nëse ka anekse që janë nënshkruar, si për shembull edhe aneks për rritjen e vlerës së kontratës.

Kontrolloni në Sistemin Elektronik për Prokurime Publike



Nëse komuna nuk i ka bërë publike të gjitha këto informacione, ato mund t'i gjeni në ueb faqen e përmendur për prokurime publike:

<https://e-nabavki.gov.mk/>.

Së pari, duhet të klikoni në dritaren përkatëse, varësisht prej informacioneve që i kërkonti: Plani për prokurime publike, Shpalljet dhe Marrëveshje të nënshkuara. Pastaj, duhet të gjeni emrin e komunës suaj (ose cilin do institucion tjetër që është i interesit tuaj) dhe pastaj të klikoni për qasje tek informacionet e dëshiruara.

Është me rëndësi të dini që mund të bëni kërkimin edhe për ndonjë lëndë konkrete të prokurimit nëse ju intereson ndonjë prokurim i caktuar, për firmë konkrete, për periudhë konkrete të shpalljes ose ndarjes së tenderit për prokurimin, etj.

Këshilla tjera për gjetje më të suksesshme të informacioneve të kërkuara në Sistemin Elektronik për Prokurime Publike:

- ▶ Gjithmonë përdorni alfabetin cirilik në tastierë kur shkruani ose kërkonti në sistemin elektronik për prokurime publike.
- ▶ Shënoni numrin e prokurimit konkret që është i interesit tuaj, për shkak se mund t'ua lehtësojë kërkimin e mëtutjeshëm vetëm duke e shënuar numrin e atij prokurimi. Çdo prokurim publik ka numër të vetëm. Për shembull: 44444/2023. Numri i parë është pesë shifror, ndërsa i dyti pas shenjës "/" e paraqet vitin kur është shpallur konkursi për prokurimin.
- ▶ Përdorni më tepër opsione dhe sinonime të ndryshme kur kërkonti ndonjë prokurim të caktuar, si për shembull: mjet motorik, mjete motorike, automjet, automjete, mjet transportues, mjete transportuese dhe ngjashëm.



Kërkoni informacione nëpërmjet kërkesës zyrtare “kërkesë për qasje të lirë”

Nëse informacionet e grumbulluara në këtë mënyrë janë pak ose të pamjaftueshme për dyshimin tuaj ose në përgjithësi për interesimin tuaj, keni të drejtë t'i kërkonti të gjitha informacionet për prokurimin e caktuar duke parashtruar në komunën tuaj, kërkesë zyrtare për qasje të lirë tek informacionet me karakter publik.

Në ueb faqen e komunës ose në ueb faqen e Agjencisë për Mbrojtjen e së Drejtës për Qasje të Lirë tek Informacionet me Karakter Publik (në linkun në vijim: <https://aspi.mk> në pjesën për Lista e bartësve të informacioneve) janë emrat dhe kontaktet e personave në institucionin (në këtë rast, komunën) tek të cilët duhet ta parashtroni kërkesën.



Në sajtin e njëjtë (në pjesën Kërkesë për qasje të lirë tek informacionet me karakter publik) mund të gjeni edhe formularin e kërkesës të cilin duhet ta plotësoni. Edhe këtu është me rëndësi ta dini numrin e prokurimit, i cili ju intereson dhe ta shënoni atë numër në parashtrësë. Vetëm shënoni që ju nevojitet dokumentacioni i plotë i dosjes për prokurimin publik me numrin përkatës të prokurimit. Kërkesën mund ta dërgoni në mënyrë elektronike, përmes e-mailit dhe në të njëjtën mënyrë ta fitoni edhe përgjigjen. Përgjigjen duhet të pritni ta pranoni në afat prej 20 ditësh. Nëse nuk i fitoni informacionet, parashtroni ankesë në Agjencinë (formularin për ankesën dhe procedurën mund t'i gjeni në sajtin, në pjesën Ankesë deri te Agjencia).



Na kontaktoni:

Qendra për Komunikime Qytetare
Bulevardi Koço Racin, nr. 26/1-2, 1000 Shkup
tel. (02) 3213-513, center@ccc.org.mk
www.ccc.org.mk, www.opendata.mk

Ky publikim është përgatitur nga Qendra për Komunikime Qytetare me përkrahjen e popullit amerikan nëpërmjet Agjencisë së SHBA-ve për Zhvillim Ndërkombëtar (USAID). Përbajtja dhe mendimet e shprehura në këtë publikim janë mendime të autorëve dhe nuk i reflektojnë qëndrimet e USAID-it ose të Qeverisë së Shteteve të Bashkuara të Amerikës.